



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-109

Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Qendra për Aftësim Profesional "SAUDA"** në Pejë, për periudhën **03.02.2017** deri **01.02.2020** për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:
 - 1.1. **Parukier/Parukiere; Niveli III sipas KKK,**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
 - 2.1 Plan-ndjekje operative dhe zëvendësim në vazhdimësi të materialeve të gjendjes aktuale të mjeteve, veglave dhe paisjeve të kandidateve të amortizuara.
 - 2.2 Përmirësimi i kushteve të konfortit i (sistemit të ngrohjes- ftohje) në qendër.
 - 2.3 Detyrimisht data e fillimit të procesit mësimor për gjithë kandidatët të regjistruar për cdo grup të ri të formuar të jetë unike.
 - 2.4 Pasurimi i dosjes së stafit me certifikatat e trajnimit për bazat e didaktikës ose mësimdhënies.
 - 2.5 Në ambjentet e brendshme të qendrës të vendoset kodi i miresjelljes.
 - 2.6 Të vendosen sinjalistikat e hyrjes dhe të daljes të qendrës.
 - 2.7 Të vendosen shkallë të jashtme për dalje të emergjencës. Të vendoset brenda ambientit të qendrës kutia e ndihmës së parë.
 - 2.8 Të vendoset brenda ambientit të qendrës kutia e sygjerimeve.

- 2.9 Për të patur një zbatim sa më të mirë të plan-programit të paraqitur nga qendra, paneli konstatoi që asistentet duhet të trajnohen me pjesëmarrje të vazhdueshme në seminare në fushën e parukerisë.
- 2.10 Të trajnohet stafi dhe të certifikohet në drejtim të mësimdhënies dhe të metodologjisë.
- 2.11 Qendra të posedojë rregullore për kandidatë me nevoja të vecanta.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **01.05.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
- "SAUDA";
 - AKK.



Bedri Xhafa

Nënkryetari i KD së AKK-së